

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSSH / Departamenti i Matjes dhe Mbeshtetjes së Tregut / Drejtoria e Raportimit, Parashikimit dhe Llogaritjes së Humbjeve / Sektori Parashikimit dhe Marrëdhënieve me Bursën e Energjisë.

SPECIALIST

Përmbledhje e Pozicionit:

Specialisti i Monitorimit dhe Parashikimit të Energjisë do të jetë përgjegjës për monitorimin e përditshëm të energjisë së hyrë në rrjetin e OSHEE-së dhe për parashikimin e saktë të qarkullimit të energjisë në rrjetin e shpërndarjes. Ky rol përfshin krijimin e raporteve të detajuara për konsumatorët dhe menaxhimin e të dhënave përmes sistemeve digjitale, duke ndihmuar në sigurimin e një furnizimi efikas dhe të besueshëm me energji elektrike.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Monitorimi i përditshëm i energjisë së hyrë në rrjet në bazë të matjeve ditore, duke përfshirë energjinë në kufirin operacional me OST (Operatori i Sistemit të Transmetimit) dhe energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme (BREE-t) të lidhura me OSHEE.
- Përgatitja e raporteve ditore për energjinë e qarkulluar në 11 rajonet e rrjetit të shpërndarjes.
- Parashikimi i energjisë totale mujore të qarkulluar në rrjetin e OSHEE-së, duke përdorur të dhëna historike, analiza të kushteve atmosferike dhe tendencat e konsumit sipas ditëve të javës dhe periudhave të ndryshme të vitit.
- Ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave në sistemin SLP (System Load Profile) për të siguruar paraqitjen e profileve orare të energjisë dhe qarkullimin e saktë të të dhënave.
- Parashikimi i profilit orar të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe vendosja e urdhërporosive (me ndarje orare) për humbjet në platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX).

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike, Energjisë, apo fusha të ngjashme.
- Përvojë në monitorimin e energjisë dhe parashikimin e konsumit energjetik.
- Aftësi të forta në analizimin e të dhënave dhe përdorimin e softuerëve për menaxhimin e energjisë.
- Njohuri të mira për platforma si SLP dhe ALPEX.
- Aftësi analitike dhe numerike të zhvilluara.
- Vëmendje e lartë ndaj detajeve dhe aftësi për të përgatitur raporte të sakta.
- Aftësi për të punuar në një mjedis të shpejtë dhe me kërkesa të larta.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.